



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:265915

Datë: 05.07.2023

Numri i dokumentit: 04457475

**PKR.nr.217/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, sipas kryetares së trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj me gjyqtarët profesionist, Murat Hulaj dhe Arben Mustafaj, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.Z., për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 3, nënpar.3.1 e 3.2, lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të përfunduar me datë 15.06.2023, në prezencë të të akuzuarit R.Z. dhe mbrojtësit të tij av.Gëzim Kollçaku me autorizim zëvendësues, e në mungesë të të dëmtuarës MBPZHR dhe Prokurorit të Shtetit Sahide Gashi, me datë 15.06.2023, ndërsa me datë 05.07.2023, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **R.Z.**, i biri i .... dhe e ëma ...., e gjinisë ...., i lindur me ....., në fsh. .... K Istog, ku edhe jeton rr. “.....”, ka të kryer shkollën e mesme, laurest i pylltarisë, i martuar baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, nr. tel. ...., me dokument identifikimi nr....., lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

**Në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK-së,**

**LIROHET NGA AKUZA**

**Për shkak se:**

Me dt. 24.11.2021, rreth orës 02:10 min., në Laurë, në vendin e quajtur “Livadhet e Istogut” K. Istog, në cilësi të personit zyrtar – Roje pylli, me dashje nuk i ka përmbush detyrat zyrtare me qëllim të mundësimit të përfitimit të kundërligjshëm për persona tjerë, këtu dëshmitarëve: V.H. në shumë prej 728,28 €(shtatëqind e njëzet e tetë euro e njëzet e tetë cent ) dhe N.Z., në shumë prej 869,04€(tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e katër cent), në kundërshtim me detyrat e tij të punës konform nenit 29, paragrafit 29, të Ligjit për Pyje të Kosovës Nr. 2003/3, të Plotësuar e Ndryshuar me Ligjin Nr.2004/29 dhe Nr. 03/L-153, në atë mënyrë që derisa policia kufitare DRPK ‘PERËNDIMI’ Gjakovë ishin në përmbushje të Planit Taktik për kapjen e kontrabanduesve me mallra, kryesisht atyre me dru hasin në një kamionët të tipit “Mercedes” të

cilin po e drejtonte këtu dëshmitari Visar të mbushur me dru teknik të llojit të breut, konkretisht me gjashtë trupa me vëllim prej 4.76m<sup>3</sup> pa dokumentacion përcjellës, e më pastaj me qëllim të verifikimit policia pasi e kalon Laurën dhe zbresin disa metra më poshtë, vërejnë një Kamionet tjetër të tipit 'Mercedes', me targa ..... që po zbriste nga Bjeshka e të cilin automjet po e ngiste këtu dëshmitari Naim dhe pasi ndalon për një periudhë kohore në Laurë, i njëjti lirohet të lëvizë nga i pandehuri në drejtim të Istogut, i cili më pas ndalohet nga ana e kësaj Patrullë dhe gjatë kontrollit të ngarkesës, të njëjtit konstatojnë se ka të ngarkuar masën drusore - dru teknik të llojit të breut gjithsej shtatë trupa, me vëllim prej 5.68m<sup>3</sup> të pa shënuara e pa leje e flet përcjellje të organit kompetent, të cilat konfiskohen dhe pasi shikohet në Fletoren zyrtare të të pandehurit, gjejnë se as në rastin e parë e as në të dytin i pandehuri fare nuk i kishte regjistruar as në hyrje e as në dalje dëshmitarët këtu, përveç të dhënat për hyrje dalje të Patrullës policore në fjalë,

-me çka ka kryer veprë penale - Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 3, nënpar.3.1 e 3.2, lidhur me par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet procedurale bien barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Pala e të dëmtuarës MBPZHR, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

Të pandehurit R.Z. i kthehet - Telefoni i tipit IPhon V, i Konfiskuar përkohësisht me Urdhër Gjykate nën DKR PP nr.213/21 e dt. 26.11.2021.

## A r s y e t i m

Me datë 10.11.2017, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngrit aktakuzë nën shenjën nën shenjën PP.nr.256/21 e dt. 03.11.2021, ndaj të akuzuarit R.Z. për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par3 nën par3.1 3,2 lidhur me npar1 të KPRK-së.*

## Kompetenca

Sipas nenit 11, paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat Nr. 03/L-199, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra penale e pretenduar ka ndodhur në Komunën e Istogut dhe rrjedhimisht bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Pejës, sipas nenit 29, paragrafi 1 i KPPRK-së. Ndërsa sipas nenit 22 par.1, nënpar.1.2, pika 1.2.74 të KPPRK-së, veprat penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtare, bien në juridiksionin e Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, e tërë lënda është gjykuar nga Departamenti i Krimeve të Rënda.

## Çështja

Sipas aktakuzës, i akuzuari pretendohet se me 24.11.2021, rreth orës 02:10 min., në Laurë, në vendin e quajtur “Livadhet e Istogut” K. Istog, në cilësi të personit zyrtar – Roje pylli, me dashje nuk i ka përmbush detyrat zyrtare me qëllim të mundësimit të përfitimit të kundërligjshëm personit tjetër, në kundërshtim me detyrat e tij të punës konform nenit 29, paragrafit 29, të Ligjit për Pyje të Kosovës Nr. 2003/3, të Plotësuar e Ndryshuar me Ligjin Nr.2004/29 dhe Nr. 03/L-153.

### Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzës, është caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor e cila ka përfunduar me dt. 15.06.2023.

### Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor

Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë rast kanë qenë publike, duke ju referuar dispozitave të KPPRK-së, konkretisht nenit 288.

Pas leximit të aktakuzës i akuzuari, nuk është deklaruar fajtor për vepër penale për të cilën është akuzuar.

Në këtë rast në aplikim të nenit 323 të KPPRK, është proceduar me fjalë hyrëse dhe radhën e paraqitjes së provave.

### Fjala hyrëse

Prokurorja e shtetit Sahide Gashi, mes tjerash tha se me rastin e administrimit të provave të propozuara në aktakuzë, do të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se këtu i akuzuari ka kryer veprën penale që i është vënë në barre, kjo më së miri do të argumentohet pas dëgjimit të dëshmitarëve, N.Z. dhe V.H. , për natën kritike se si është zhvilluar ngjarja, dëshmi të cilat do të sforcohen dhe nga dëshmitarët, V.M. dhe M.M. . Se si i akuzuari është hasur në flagrancë natën kritike, do të vërtetohet edhe nga raportet e hetuesve policor dhe policisë së natës kritike me nr. 2021-YWA-118 dt. 24.11.2021 e tutje, oficeri Xh.J. e Hysen Ademaj, vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me të njëjtit numër dhe datë, ditarin e punës së të akuzuarit me mbishkrim fletorja zyrtare për hyrje - dalje në laurë, foto dokumentacionit si dhe nga raportet e vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve të rastet e ndërlidhura me këtë çështje nr. 2021-YWA-117 të të njëjtës datë.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Gëzim Kollçaku, në fjalën e tij hyrëse, tha se gjatë shqyrtimit gjyqësorë, do të vërtetohet se i mbrojturi i tij, asnjëherë nuk ka qenë roje pylli, andaj dhe nuk mund ta ketë statusin e personit zyrtar, pasi nuk ka qenë i punësuar Agjencinë Pyjore të Kosovës. Do të vërtetohet se në kohen kur pretendohet kryerja e veprës penale, ai ishte praktikant në bazë të marrëveshjes për kryerjen e praktikës profesionale të lidhur në mes OJQ “Syri Vizion” dhe Komunës së Istogut, dhe atë në kohëzgjatje prej 6 muaj duke filluar prej 4 gusht 2021 deri me dt. 31.01.2022.

I akuzuari, e ka mbështetur në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Në cilësi të provës janë administruar, provat e propozuara nga Prokuroria, sipas aktakuzës janë dëgjuar dëshmitarët, si vijon:

- N.Z. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.05.2023;
- V.H. , në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.05.2023;
- V.M. , në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.05.2023;
- M.M. , në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.05. 2023;

*Provat materiale:*

1. Raport Fillestar i Incidentit me Nr. 2021- YWA-118 i dt. 24.11.2021
2. Raporti i oficerit Xhevdet Jusufi i dt. 24.11.2021 Nr. 2021- YWA-118
3. Raporti i hetuesit Hysen Ademaj i dt. 24.11.2021
4. Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve 2021- YWA-118 i dt. 24.11.2021
5. Kopjet e shënimeve mbi hyrjet dhe daljet tek Laura dt. 22.11.2021
6. Ditari i punës në lidhje me hyrje daljet –Fletorja Zyrtare
7. Foto dokumentacioni i kontakteve nga telefoni i të pandehurit.
8. Raporti për Ekspertim nga ana e AKF –ës në Prishtinë i Telefonit të sekuestruar - pronë e të pandehurit, Nr. AKF-2022 – 0443 i dt. 25.10.2022,
9. Raporti Fillestar i Incidentit nr. të rastit 2021- YWA-117, i dt.24.11.2021
10. Fillesh Raport nr. të rastit 2021- YWA-117, i dt.24.11.2021
11. Raport i oficerit Can Zeqiraj nr. të rastit 2021- YWA-117, i dt.24.11.2021
12. Vërtetimi mbi sekuestrimin e nr. të rastit 2021- YWA-117, i st.24.11.2021
13. Procesverbali Nr. 001132 e dt. 24.11.2021 e Sektorit të Pyltariisë mbi Konfiskimin e asortimenteve drusore nga N.Z..
14. Fotokopja e Lejes së Qarkullimit për automjetin Nr. CRA 1139114 për kamioneten të cilën po e drejtonte N.Z.
15. fotoalbumi

Ndërsa me propozimin e prokurores së shtetit në shqyrtim gjyqësor, janë administruar provat si më poshtë:

- Kontrata e punës e siguruar nga Komuna e Istogut me nr. 01-339/020 e dt.03.07.2020, e lidhur mes Komunës së Istogut si punëdhënës përfaqësuar nga H.R. dhe R.Z. si punëmarrës.
- Përgjigja e dt. 25.05.2023 nga i njëjti autoritet, lidhur me vendin e punës të tani të akuzuarit.

Me propozim të mbrojtësit të të akuzuarit av. Gëzim Kollçaku, janë administruar provat si më poshtë:

- Kontrata për kryerjen praktikës profesionale si praktikant në Komunën e Istogut për periudhën 4 gusht 2021 deri me 31 janar 2022.

Gjykata ka refuzuar propozimin e prokurores së shtetit që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen zyrtarët policor, A.Z., Xh.J., A.H. dhe C.Z., nën arsyetim se të njëjtit kishin përpiluar raporte policore për veprimet e tyre, andaj dhe nuk është pa e arsyeshme për të njëjtat rrethana të dëgjohen.

### Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari R.Z., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.06.2023, ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje.

Ndërsa në polici me dt. 24.11.2023 dhe në prokurori me dt. 22.12.2023, ka mohuar kryerjen veprës penale. Ditën kritike, ishte me detyrë në Laurë, në cilësi të praktikantit, i sistemuar sipas marrëveshjes së përpiluar mes Komunës së Istogut dhe OJQ, dhe atë, në vendin e quajtur “Livadhet e Istogut” K. Istog, ku rreth orës 02:05 min, të mëngjesit, për shkak të motit të lig nuk kishte pasur mjaftueshëm ndriçim, për shkak se për ndriçim ishte shfrytëzuar energjia solare, andaj dhe nuk ka shënuar në librin e tij rastin në fjalë, mirëpo posa kishte nis të zbardhi dita, në rubrikë e kishte shënuar si vërejtje.

Është arsyetuar se atë natë, pra në orët e hershme të mëngjesit, ka kaluar policia nën shoqërim të një personi i cili ngiste një kamion të ngarkuar me dru teknik të bre, ndërsa 5 minuta pas tyre kishte ardhur nga mali një person tjetër, të cilin si figurë e ka njohur, e i cili drejtonte një kamionet të tipit “Mercedes”, të ngarkuar me dru. Personi në fjalë, posa është ndaluar tek Laura në fjalë, i kishte thënë se është duke e prit policia, sepse ishte nën përcjellje të tyre, kështu që duke e vënë në lajthim e ka lejuar të kalojë. I pyetur se a ishte njoftuar nga policia se ishte dhenjë person tjetër nën përcjellje të tyre, tha se për këtë nuk ishte njoftuar.

Sa i përket thirrjeve telefonike të paralizuar, është arsyetuar se ka provuar atë natë ta kontaktojë M.M.disa herë, me qëllim që ta pyes nëse e di emrin e personit në fjalë, andaj dhe kjo kishte qenë arsyeja se në librin e tij, e ka shënuar si vërejtje.

### Fjala përfundimtare

Me datë 27.02.2023, palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare në formë të shkruar.

### Përmbajtja e fjalës përfundimtare

Prokurori e shtetit, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar, ka deklaruar se pas administrimit të provave materiale dhe personale (të elaboruara më gjerësisht në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar), është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë

se këtu i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kjo gjendje faktike është vërtetuar mbi bazën e deklaratimit të dëshmitarëve të cilët sipas, ishin recidivist dhe se me të njëjtit kishte bashkëpunuar, ngase vet këta dëshmitarë kishin pohuar se kanë të kaluar kriminale. Këtë bashkëpunim e ndërlidhe me provën materiale- thirrjet telefonike të perealizuara në drejtim të M.M. , ani pse këtu i akuzuari ishte arsyetuar se donte ta kuptonte se si e kishte emrin, personi që e ka njohur si fytyrë, e të cilin Muja e ka njohur. Se i akuzuari, deklaratën e tij në faza të mëhershme e kishte në kundërshtim me prova materiale, tregon dhe raporti për ekspertim nga AKF-së në Prishtinë, i telefonit të të akuzuarit si dhe provat ndërlidhëse të rastit që kanë të bëjnë me procedurë ndaj N.Z., këtu dëshmitarit, për prerje ilegale të druve. Ka shtuar, se si rrjedhojë e gjithë kësaj, i akuzuari nuk ka mohuar të ketë lidhje familjare e miqësie me personat në fjalë.

Në fund ka propozuar që deklaratave të dëshmitarëve të mos u falet besimi, kështu që i akuzuari, të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit, të obligohet në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të shqiptohet dënim plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratë publike ose në shërbimin publik, derisa telefoni i sekuestruar sipas urdhrit të gjykatës DKR.PP.nr 213/21 dt.26.11.2021, ti kthehet të akuzuarit.

Në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të të akuzuarit, av.Gëzim Kollçaku, mes tjerash tha se prokuroria, R.Z.n, e ka akuzuar se me dt. 24.11.2021, rreth orës 02:10, në cilësi të personit zyrtar – roje pylli me dashje nuk i ka përmbush detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për personat tjerë. Në lidhje me këtë pretendim prokuroria, as para ngritjes së aktakuzës, e as gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk ofrojë asnjë të vetmen provë se këtu i akuzuari për këtë periudhë kohore ka qenë person zyrtarë. Me tej tha se, prokurorja në fjalën e saj përfundimtare, u bazua në një kontratë të punës, të cilën gjykatës ia prezantojë si provë gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësorë, edhe përkundër faktit se kontrata në fjalë, ishte e vlefshme prej dt. 03.07.2020 -02.07.2021, që do të thotë se prokuroria thirret në prova të cilat nuk kanë fare të bëjnë me këtë çështje. Se me të vërtetë i mbrojturi i tij nuk ka qenë person zyrtar në kohën e kryerjes së veprës penale, tha se është vërtetuar me provën materiale – marrëveshjen e lidhur mes Komunës së Istogut dhe OJQ “Syri Vizion”, ku i njëjti ishte pranuar si praktikant profesionist, për periudhën kohore nga data 04.08.2021-31.01.2022, dhe si i tillë nuk mund të përgjigjet për veprën penale keqpërdorim i detyrës zyrtare, për faktin se këto vepra janë të dedikuar ekskluzivisht për persona që kanë statusin e personit zyrtar dhe kjo caktohet me ligj.

Si përfundim ka propozuar që konform nenit 364 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, të merret aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit ngase gjatë gjithë procedurës nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari R.Z., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

### Deklarimi i dëshmitarëve

Dëshmitari N.Z., ne seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 18.05.2023, mes tjerash tha se të pandehurin e ka njohtë si figurë. Natën, përkatësisht mëngjesin e dt. 24.11.2021, rreth orës 02:10 min, derisa ishte duke u lëshuar nga mali, me kamioneten e tij, të ngarkuar me trupa, të cilët i

kishte bërë të gatshëm, 3 apo 4 ditë më parë, ka vërejt policinë dhe nga frika se do e zënë, ka prit derisa ata të largohen nga aty, pasi ka pa se e kishin zënë një person tjetër me dru, e i cili ishte nën përcjellje të tyre. Ai me tej tha se, kishte perceptim se mund tu shmangej, meqë trupat i kishte pre pa leje paraprake, por sipas tij, nuk ishte i sigurt se a i kishte pre në territorin e Kosovës, apo të Serbisë. Pasi policia ishin nis, ai me kamionetën e tij, pa drita të ndezura niset dhe me të arritur tek rampa në vendin i quajtur "Livadhet e Istogut", has në këtu të akuzuarin, e të cilin në mënyrë që mos ta ndalojë, e vënë në lajthim, se kinse ishte nën përcjellje të policisë dhe se e kishte problem të ndalojë, pasi nuk kishte frena. Me të kaluar Laurën, pas 200 metrash, ishte ndaluar nga policia, dhe nga të njëjtit ishte dërguar në stacion policor.

I pyetur se cilat ishin veprimet e këtu të akuzuarit, ai tha se ishte pyetur nga i njëjti se ku ishte duke shkuar dhe se a ishte çdo gjë në rregull, mirëpo e ka gënjyer, duke i thënë pra se ishte nën përcjellje të policisë dhe i kishte kërkuat ta hap rampën shpejt, pasi nuk kishte frena.

Ky dëshmitar, ka dhënë deklaratë në polici me dt. 07.12.2021, dhe prokurori me dt. 22.12.2021, mirëpo deklarata në prokurori, ishte marr në kundërshtim me nenin 129 par. 6 i KPPRK-së, përkatësisht me nenin, 329 të KPPRK-së, që ishte në fuqi në kohën kur kishte dhënë deklaratë, ashtu që nga gjykata, është vlerësuar se nuk mund të përdoret në shqyrtim gjyqësor, gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ashtu siç e përcakton dispozita e nenit 119 par 3 të KPPRK-së dhe nenit 251 par 2 të KPPRK-së, dispozitë e cila shprehimisht përcakton se *“provat e marrë në shkelje të dispozitave të KPPRK-së, janë të papranueshme...”*, derisa dispozita e nenit 255 par 2 e KPPRK-së, përcakton se *“provat mund të shqyrtohen nga gjyqtari i vetëm gjykues, apo kryetari i trupit gjykues, gjatë shqyrtimit kryesorë, nëse nuk janë përjashtuar sipas nenit 243 apo nëse nuk është e pranueshme sipas nenit 253 të KPPRK-së”*.

Në këtë rast, deklaratat e dëshmitarit, dhënë në polici dhe prokurori, nga gjykata është vlerësuar se nuk mund të përdoren si provë.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.05.2023, dëshmitari **V.H.**, mes tjerash tha se bashkëshortja e tij, të akuzuarin R. e ka dajë. Natën kritike kishte shkuar në vendin e quajtur Bajshe, dhe për ti ik laurës, kishte përdor rrugë aksesore, pra fillimisht në Moke, nga aty në Jerebija, më pas Radushe dhe në fund në Bajshe, ku kishte ngarkuar një kamionet me trupa të Breut, të cilët një natë më parë i kishte bërë të gatshme. Vendi i quajtur Bajshe, nuk e dinte se i përket territorit të Kosovës, apo Serbisë. Posa i kishte ngarkuar trupat, ishte zënë nga policia dhe nën përcjellje të tyre, ka kaluar kah laura, ku ka qenë R. . Nuk ishte në dijeni, nëse është dashur të ndalojnë tek laura, kur janë nën përcjellje të policisë, mirëpo, për prerje ilegale ishte ndaluar për 48 orë.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.05.2023, dëshmitari **V.M.**, dëshmia e të cilit, lidhur me rrethanat e natës kritike, nuk ishin relevante, megjithatë, ai u pyet, nëse ka lidhje familjare me të akuzuarin, të cilin e njihte, pasi motrën e kishte të martuar për një kushëri të tij dhe se a kishte kontaktuar natën kritike me të njëjtin, ku sipas tij, natën kritike nuk kishte pas biseda, ishte e mundur një natë më parë të ketë kontaktuar, po ashtu nuk e mohoj faktin se ishte i dënuar për vepra penale, Vjedhje Pylli.

I dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.05.2023, dëshmitari, **M.M.**, mes tjerash tha se të akuzuarin e ka djalë të xhaxhait të nënës. Sa i përket natës kritike, ai tha se nuk kishte dijeni se çka kishte ndodhur e as që kishte kontaktuar, apo biseduar me këtu të akuzuarin dhe se nuk mund ta dinte, nëse i akuzuari kishte provuar ta kontaktojë.

Analizimi i provave materiale

**Nga Raporti i shpejt Nr. 2021- YWA-118 i dt 24.11.2021, vërtetohet iniciimi i rastit.**

**Nga Raporti i oficerit Xhevdet Jusufi i dt 24.11.2021 dhe nga Raporti i hetuesit Hysen Ademaj i dt 24.11.2021, vërtetohen veprimet e zyrtarëve policor lidhur me sigurimin e provave të rastit.**

**Nga Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, vërtetohet sigurimi i kopjeve dhe shënimeve mbi hyrjet dhe daljet tek Laura për dt. 22.11.202,**

**Nga Ditari i punës, vërtetohen shënimet lidhur me hyrje /daljet e natës kritike**

**Nga Raporti për Ekspertim nga ana e AKF –ës në Prishtinë i Telefonit të sekuestruar - pronë e të pandehurit, Nr. AKF-2022 – 0443 i dt. 25.10.2022, me nr rasti 2021- YWA-118, rezulton se këtu i akuzuari, ka provuar të kontaktojë persona të ndryshëm, por jo dhe këtu dëshmitarët N.Z. dhe V.H. .**

***Nga Rasti i ndërlidhur me Nr të rastit 2021- YWA-117 si:***

- a) Vërtetimi mbi sekuestrimin e nr të rastit 2021- YWA-117, i st.24.11.2021
- b) Procesverbali Nr. 001132 e dt. 24.11.2021 e Sektorit të Pylttarisë mbi Konfiskimin e asortimenteve drusore nga N.Z.
- c) Fotokopja e Lejes së Qarkullimit për automjetin Nr. CRA 1139114 për kamionetën të cilën po e drejtonte N.Z.
- d) Fotodokumentacioni si dhe të dyshuarit V.H.

**Vërtetohet** se këtu dëshmitarët N.Z. dhe V.H. , lidhur me veprimet e tyre, nga ana e policisë, ishte hapur rast.

Nga Kontrata e punës e siguruar nga Komuna e Istogut me nr. 01-339/020 e dt.03.07.2020, e lidhur mes Komunës së Istogut si punëdhënës përfaqësuar nga H.R. dhe R.Z. si punëmarrës, vërtetohet se këtu i akuzuari ishte i punësuar si pylltar në periudhën kohore që nuk ndërlidhej me kohën e kryerjes së veprës penale. e që ndërlidhet dhe me provën materiale - Përgjigja e dt. 25.05.2023 nga i njëjti autoritet, lidhur me vendin e punës të tani të akuzuarit.

Nga Kontrata për kryerjen praktikës profesionale si praktikant në Komunën e Istogut për periudhën 4 gusht 2021 deri me 31 janar 2022, vërtetohet se këtu i akuzuari kishte punuar si praktikant pranë K. së Istogut, sipas një marrëveshje të lidhur mes Komunës së Istogut dhe OJQ “ Syri Vizion”

Vlerësimi i provave dhe ndërlidhja e tyre në raport me veprimet e të akuzuarit



Gjykata pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor, e në kuptim të nenit 360 par.2 të KPPRK-së, duke i vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë ka gjetur se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, këtu i akuzuari Z., të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari, ka punuar në Komunën e Pejës, në bazë të Kontratës, për kryerjen praktikës profesionale si praktikant në Komunën e Istogut për periudhën 4 gusht 2021 deri me 31 janar 2022.

Nuk ishte kontestues fakti se me dt. 24.11.2021, rreth orës 02:10 min., në Laurë, në vendin e quajtur "Livadhet e Istogut" K. Istog, këtu dëshmitarët V.H. dhe N.Z., ishin kap nga policia kufitare DRPK 'Përendimi' Gjakovë.

Kontestuese deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana nëse i akuzuari a e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej.

*Nga deklarata e dëshmitarit, N.Z., kjo gjykatë vërtetojë faktin se këtu i akuzuari kishte qenë duke punuar si laurist, tek rampa në vendin i quajtur "Livadhet e Istogut".*

Vërtetojë faktin se në momentin kur ky dëshmitarë, ka parë të akuzuarin, kishte kërkuar nga i njëjti që ta lejojë të kaloj, se kinse ishte nën përcjellje të policisë

Vërtetojë faktin se pas 200 metra lëvizje, ishte zënë nga policia me kamioneten e tij të ngarkuar me masën drusore - dru teknik të llojit të bre, gjithsej shtatë trupa, me vëllim prej 5.68m<sup>3</sup> të pa shënjuara e pa leje e flet përcjellje të organit kompetent.

Vërtetojë faktin se për veprimet e tij ishte iniciuar procedurë dhe se masa drusore ishte konfiskuar.

Vërtetojë faktin se dy ditë më parë, e kishte përgatitë masën drusore, dhe për të shkuar tek vendi ku i ka pre, kishte shfrytëzuar rrugë aksesore, për ti ikur laurës,

*Nga deklarata e dëshmitarit, V.H. , kjo gjykatë vërtetojë faktin se këtu i akuzuari kishte qenë duke punuar si laurist, tek rampa në vendin i quajtur "Livadhet e Istogut".*

Vërtetojë faktin se natën kritike ishte zënë në flagrancë nga policia kufitare DRPK 'PERËNDIMI', me kamionet të tipit "Mercedes" të mbushur me dru teknik të llojit të breut, konkretisht me gjashtë trupa me vëllim prej 4.76m<sup>3</sup> pa dokumentacion përcjellës.

Vërtetojë faktin se kishte shfrytëzuar rrugë aksesore për të dal në mal në vendin e quajtur Bajshe për prerje.

Vërtetojë faktin se nga lauristi nuk ishin ndaluar, pasi ishte nën përcjellje të policisë.

Dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve, gjykata i mori të besueshme, ngase nuk u vunë në dyshim me prova tjera, gjegjësisht gjetën përputhje dhe me prova materiale, raporte policore dhe provat tjera që kishin të bëjnë me rastin i inicimit të procedurës për këta dëshmitarë, për veprime të tyre, si dhe me mbrojtjen e të akuzuarit, i cili në mënyrë identike kishte deklaruar në polici dhe prokurori, lidhur me veprimet e tij në natën kritike.

*Derisa dëshmitarët V.M. dhe M.M., lidhur me ngjarjen e rastit konkret, nuk vërtetuan ndonjë fakt, pasi nuk ishin të përfshirë në asnjë mënyrë. Këta dëshmitarë u dëgjuan për të kuptuar nëse këtu i akuzuari i kishte kontaktuar atë natë, e të cilët mohuan të kenë pasur ndonjë kontakt telefonik, rrethanë e vërtetuar dhe nga prova materiale **Raporti për Ekspertim nga ana e AKF –ës në Prishtinë** i Telefonit të sekuestruar - pronë e të pandehurit, Nr. AKF-2022 – 0443 i dt. 25.10.2022 , me nr rasti 2021- YWA-118, nga i cili rezulton se këtu i akuzuari, ka provuar të kontaktojë persona të ndryshëm, mesin e tyre dhe këta dëshmitarë, por nuk ka rezultuar të jetë realizuar telefonata. Andaj dhe dëshmime të tyre lidhur me këtë fakt, u fali besimin.*

I akuzuari në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor, ka vendosur që të mbrohet në heshtje, Gjykata, bazuar në nenin 122 par.3 KPPK-së, ka marrë për bazë deklaratat e mëhershme të tij dhënë polici dhe prokurori, të cilave u fali besimin pas parasysh se një mbrojtje e tillë gjeti mbështetje në prova tjera, përkatësisht me deklaratën e dëshmitarëve Naim dhe Visar, si dhe raportet policore, e në veçanti se nuk ishte roje pylli sipas pretendimit të prokurorisë, por si praktikant në Komunën e Istogut për periudhën 4 gusht 2021 deri me 31 janar 2022,

Përkatësisht, se ishte vënë në lajthim nga dëshmitari Naim, këtë e vërtetojë me dëshminë e tij vet ky dëshmitar, në të gjitha fazat e procedurës.

Se a kishte pas obligim të shënojë në librin e tij çdo person që kalonte kah laura, ai dha arsyet, megjithatë provat tjera nuk vërtetuan të kundërtën, përkatësisht nuk vërtetuan se kishte vepruar me qëllim që tu mundësoj përfitim, këtu dëshmitarëve Naim dhe Visar, kjo u provua dhe nga rrethana se ai kishte provuar të kontaktojë M.M.disa herë, me qëllim që ta pyes nëse e di emrin e personit në fjalë, rrethanë e vërtetuar dhe me provën materiale Ditari i punës, së të akuzuarit lidhur me hyrje /daljet e natës kritike, ku në mungesë të dritës së mjaftueshme, e kishte shënuar vetëm si vërejtje, andaj dhe në mungesë të vërtetimit të fakteve ndryshe nga dhënia e mbrojtjes së tij, gjykata i fali besimin.

### Vlerësimi juridik

Vepra penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së*, përbëhet nga elementet objektive e që janë veprimi dhe pasoja (Actus Reus) ashtu si dhe nga qëllimi kriminal (Mens rea) lidhur me secilin element të veprës penale. Për të ekzistuar një vepër penale, këto elemente duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Vepra penale në fjalë, si e tillë, mund të kryhet me veprim dhe vetëm me dashje direkte të kryesit. Kur jemi tek dashja, e njëjta duhet të paraqitet si në veprim e poashtu edhe në pasojë, sidomos tek vepra penale që është objekt shqyrtimi, pasi që forma të tjera të fajit, tek kjo vepër nuk mund të vijnë në shprehje.

Nga të vërtetuarat më lartë është gjetur se këtu i akuzuari, ka pas obligim që të ndalojë këtu dëshmitarin N.Z., mirëpo i njëjti, ishte vënë në lajthim nga vet dëshmitari, dhe duke e parë se u ndalua nga policia, të cilët vetëm pak min. më parë kishin kaluar kah Laura duke përcjellë dëshmitarin V.H. , ai e kishte kuptuar se ishte mashtruar, andaj dhe ka provuar të kontaktojë M.M. për t'ia marr emrin, mirëpo në pamundësi të bie në kontakt, në ditarin e tij e kishte shënuar vetëm “vërejtje”, andaj dhe përkundër shkaktimit të pasojës, kjo gjykatë gjeti se nuk është plotësuar elementi subjektiv i veprës penale, pra dashja e të akuzuarit, veprimet e tij inkorporohen si pakujdesi, mirëpo kjo vepër penale, nuk inkriminohet kur kryhet nga pakujdesia.

Veprimi kriminal i të akuzuarit, siç pretendohet në aktakuzë, si element objektiv i veprës penale, mbeti i pa plotësuar, sepse nga elaborati i mësipërm i provave materiale e po ashtu edhe atyre personale, e që janë dëshmitë e dëshmitarëve, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprime të qëllimshme, për të shkaktuar pasojën e pretenduar, respektivisht, nëse qëllimi i tij kriminal të ketë qenë kryerja e veprës penale, për të cilën edhe është akuzuar, pra e domosdoshme është që të ketë ekzistuar relacioni psikik (mendor) i të akuzuarit me veprën e tij dhe pasojat e asaj vepre.

Gjykata tërheq vëmendjen se vepra penale *keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së*, si objekt mbrojtës të saj e ka detyrën zyrtare, e cila hynë në kategorinë e veprave penale të njohura si *delicta propria*, e të cilat mund të kryhen vetëm nga një kategori e caktuar e personave. Konkretisht, këto vepra penale mund t'i kryejnë personat të cilët janë bartës të këtyre autorizimeve zyrtare, apo personat që kanë kompetenca për të kryer autorizimet zyrtare të caktuara, vetëm me dashje direkte.

Prokuroria pretendon se i akuzuari nga Me dt. 24.11.2021, rreth orës 02:10 min., në Laurë, në vendin e quajtur “Livadhet e Istogut” K. Istog, në cilësi të personit zyrtar – Roje pylli, me dashje nuk i ka përmbush detyrat zyrtare me qëllim të mundësimit të përfitimit të kundërligjshëm për persona tjerë, këtu dëshmitarëve: V.H. në shumë prej 728,28 €(shtatëqind e njëzet e tetë euro e njëzet e tetë cent ) dhe N.Z., në shumë prej 869,04€(tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e katër cent), në kundërshtim me detyrat e tij të punës konform nenit 29, paragrafit 29, të Ligjit për Pyje të Kosovës Nr. 2003/3, të Plotësuar e Ndryshuar me Ligjin Nr.2004/29 dhe Nr. 03/L-153, në atë mënyrë që derisa policia kufitare DRPK ‘PERËNDIMI’ Gjakovë ishin në përmbushje të Planit Taktik për kapjen e kontrabanduesve me mallra, kryesisht atyre me dru hasin në një kamionët të tipit “Mercedes” të cilin po e drejtonte këtu dëshmitari Visar të mbushur me dru teknik të llojit të bre, konkretisht me gjashtë trupa me vëllim prej 4.76m<sup>3</sup> pa dokumentacion përcjellës, e më pastaj me qëllim të verifikimit policia pasi e kalon Laurën dhe zbresin disa metra më poshtë, vërejnë një Kamionet tjetër të tipit ‘Mercedes’, me targa ..... që po zbriste nga Bjeshka e të cilin automjet po e ngiste këtu dëshmitari Naim dhe pasi ndalon për një periudhë kohore në Laurë, i njëjti lirohet të lëvizë nga i pandehuri në drejtim të Istogut, i cili më pas ndalohet nga ana e kësaj Patrullë dhe gjatë kontrollit të ngarkesës, të njëjtit konstatojnë se ka të ngarkuar masën drusore - dru teknik të llojit të bre gjithsej shtatë trupa, me vëllim prej 5.68m<sup>3</sup> të pa shënuara e pa leje e flet përcjellje të organit kompetent, të cilat konfiskohen dhe pasi shikohet në Fletoren zyrtare të të pandehurit, gjejnë se as në rastin e parë e as në të dytin i pandehuri fare

nuk i kishte regjistruar as në hyrje e as në dalje dëshmitarët këtu, përveç të dhënat për hyrje dalje të Patrollës policore në fjalë,

Mirëpo, bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, është gjetur se i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i punësuar në Komunën e Istogut si praktikant profesional dhe në bazë të nevojave të Komunës ishte sistemuar si laurist e jo si roje pylli siç pretendon prokuroria, rrethanë të cilën e mbështeti në provën materiale - Kontrata e punës e siguruar nga Komuna e Istogut me nr. 01-339/020 e dt.03.07.2020, e lidhur mes Komunës së Istogut si punëdhënës përfaqësuar nga H.R. dhe R.Z. si punëmarrës, nga e cila rezulton se si roje pylli ishte i punësuar në periudhën kohore që nuk ndërlidhej me kohën e kryerjes së veprës penale, siç dhe është dhënë përgjigja që rezulton me provën materiale - Përgjigja e dt. 25.05.2023 nga i njëjti autoritet, lidhur me vendin e punës të tani të akuzuarit.

Por, bazuar në punën që ai kryente si praktikant profesioanal, kjo gjykatë vlerësojë se edhe pozita e praktikantit që ushtron praktikën e një pylltari- lauristi, ka të njëjtat detyra dhe autorizime me detyrat e konform nenit 29, paragrafit 29, të Ligjit për Pyje të Kosovës Nr. 2003/3, pra ka pozitën e personit zyrtar, andaj dhe pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit lidhur me këtë rrethanë është i pa bazuar, megjithatë edhe pse kishte pozitën e personit zyrtar, nuk u vërtetua se me dashje veproj në kundërshtim me detyrat e tij zyrtare, këtu i akuzuari, me qëllim që tu mundësojë përfitim të kundërligjshëm personave tjerë, në këtë rast, dëshmitarëve: V.H. në shumë prej 728,28 €(shtatëqind e njëzet e tetë euro e njëzet e tetë cent ) dhe N.Z., në shumë prej 869,04€(tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e katër cent).

Me këtë rast, gjykata ka parasysh parimet mbi të cilat është e ndërtuar procedura penale, në të cilin roli i gjykatës është pasiv, dhe barra e të provuarit lidhur me ekzistimin apo jo të një vepre penale, i bie prokurorisë së shtetit, pasi që e njëjta është bartëse e akuzës dhe zhvillon hetime për veprat penale për të cilat konsideron që kanë dyshim të bazuar mirë, e që më pas mund të marrin një epilog në favor të akuzës.

Aktakuza u mbështet në deklaratat e dëshmitarëve të propozuar në aktakuzë, të cilët që nga fillimi i procedurës dhanë dëshmi të njëjtë, andaj propozimi i prokurorisë që të njëjtëve të mos u falet besimi, për gjykatën ishte i pakuptueshëm, sepse prokuroria ka detyrim ligjor, që para se të ngrit aktin akuzues, saktësisht dhe tërësisht ti vërtetojë faktet të cilat janë të domosdoshme për marrje të vendimit, siç e përcakton neni 7 i KPPRK-së, dispozitë ligjore që obligon dhe gjykatën. Pretendimi i prokurorisë, që i njëjti ka provuar të kontaktojë persona me precedent penal, nuk vërteton elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, e në veçanti në mungesë të provave tjera.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarës në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, u morr konform nenit 462 par.3 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 360 dhe 363 par. 1.3 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr. 217/22**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Elzana Kastrati

**Kryetarja e trupit gjykues**  
Nushe Kuka Mekaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.